



**UNIVERSITETI I TIRANE**  
**FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I ANGLISHTES**

**PROGRAMET E LENDEVE TE CIKLIT TE DYTE TE STUDIMEVE,**

**VITI AKADEMIK 2016-2019**

**MASTER I SHKENCAVE NE “GJUHË DHE KOMUNIKIM NDËRKULTUROR E  
TURISTIK”**

**Letërsi dhe Kulturë B**

<b>Programi i lëndës</b>	
<b>Moduli:</b>	Letërsi dhe Kulturë B
<b>Cikli:</b>	Master
<b>Fusha e formimit</b>	Letërsi dhe Kulturë
<b>Kursi kurrikular</b>	Gjuhë dhe Komunikim Kulturor dhe Turistik
<b>Kursi:</b>	I
<b>Viti/Semestri:</b>	2016-2017/i parë
<b>ETCS:</b>	8 Kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b>	60 orë
<b>Nr. Seminareve:</b>	20 orë
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof. Dr. Maks Daiu; Dr. Albana Lilaj; Dr. Iris Kokoli (Klosi); Msc. Brunilda Kondi

## **PËRSHKRIMI I MODULIT**

### **Objektivat e kursit:**

Lënda Kulturë Britanike B zhvillohet në semestrin e parë të vitit të parë të Masterit Shkencor në Komunikim turistik dhe kulturor si një pjesë e Modullit Letërsi dhe Kulturë B. Lënda përmban gjithsej 20 orë nga të cilat 15 janë leksione dhe 5 seminare.

Kjo lëndë synon të pajisë studentët me njohuri mbi institucionet britanike, besimet dhe zhvillimet e ndryshme turistike dhe kulturore. Temat janë konceptuar të jenë të kuptueshme dhe në funksion të profilit të studimeve master. Niveli i temave të zgjedhura përputhet me nivelin e studentëve të cilët pritet të kenë aftësi analitike dhe interpretative dhe të përmirësojnë më shumë aftësitë e tyre gjuhësore dhe mënyrën e të menduarit nëpërmjet diskutimeve të shumta gjatë seminareve. Metodologjia e përdorur do të jetë nëpërmjet ciklit të leksioneve të siguruara nga pedagogu i lëndës, libri bazë si dhe materiale shtesë në formë artikujsh. Gjithashtu, tre orët e fundit të lëndës përcaktohen për paraqitjen e një projekti në bazë grupi.

Pjesa Studime Amerikane brenda Modullit Letërsi dhe Kulturë B u jep studentëve njohuri të zhvillimeve të rëndësishme aktuale për institucionet, besimet dhe jetën në Shtetet e Bashkuara të Amërikës. Kursi realizohet në 20 seanca.

### **Objektivat e kursit:**

Ky kurs synon:

- të pajisë studentët me njohuri shtesë mbi kulturën dhe institucionet Britanike, ku një pjesë njohurish të përgjithshme pritet t'i kenë përvetësuar në ciklin Bachelor.
- t'u japë njohuritë e mjaftueshme në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të kuptojnë dhe perceptojnë mirë temat e caktuara nga pedagogu i lëndës.
- të zhvillojë më tej aftësitë e studentëve në lidhje me shprehjen e mendimeve kritike, komenteve pro apo kundër, parashtrimin të një çështjeje për diskutim.

Kursi synon të pajisë studentët me shprehitë për të lexuar, kuptuar, analizuar dhe komentuar mbi temat e diskutuara dhe materialet e përdorura në klasë.

### **Rezultatet e pritshme:**

Në këtë kurs studentët pritet:

- të përvetësojnë njohuritë kulturore mbi institucionet britanike dhe konceptet politike e ligjore.
- Të shtrojnë probleme dhe të nxjerrin përfundime
- Të përgatisin ese me një kompetencë gjuhësore dhe kulturore të nivelit master
- Të kenë zhvilluar aftësitë e tyre analitike, gjuhësore dhe kritike në lidhje me çështjet.

Me përfundimin me sukses të kursit, studentët do të jenë në gjendje të analizojnë artikuj të marrë nga media në bazë të prirjeve kulturore që ato paraqesin. Ata do të jenë në gjendje të prezantojnë mbi një temë kulturore e të shkruajnë në mënyrë kritike për një aspekt kulturor.

### **Metoda didaktike**

Metoda didaktike e përdorur do të përqendrohet në leksionet e përgatitura nga pedagogu i lëndës, literatura e detyruar dhe e rekomanduar, diskutimet, pyetjet dhe esetë, provimi mes-semestral, projekti përfundimtar dhe provimi përfundimtar.

Leksione me powrpoint, seminare organizuar me diskutime me studentët mbi artikuj dhe klipe mediatike aktuale, prezantime nga studentët. Të ftuar diplomatë amerikanë.

### **VLERËSIMI**

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

- British Civilization, an Introduction. John Oakland. Routledge. London and New York. 2002. (available free download or as a printed book ISBN 0-203-37416-9 (Adobe Reader Format)
- Stevenson, D.K. (1998). *American Life and Institutions* (Revised ed.) Office of English Language Programs United States Bureau of Educational and Cultural Affairs
- Leksionet e dhëna me fotokopje

### **BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR**

- Different articles or journals covering topics on Britain and The EU, Britishness and Englishness, the Judiciary, Tourism and Film Industry.

- Asitimbay, D. (2005). *What's Up America A Foreigner's Guide to Understanding Americans*, Culture Press, San Diego, CA

### Komunikim turistik

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	KOMUNIKIM TURISTIK
<b>Cikli:</b>	II
<b>Fusha e formimit</b>	
<b>Kursi kurrikular</b>	Formim gjuhësor dhe kulturor në fushën e turizmit
<b>Kursi:</b>	I
<b>Viti/Semestri:</b>	I/I
<b>ETCS:</b>	6 kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b>	30 orë leksione
<b>Nr. Seminareve:</b>	30 orë seminare
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Irena Pata Kapo

### PËRSHKRIMI I MODULIT

#### Objektivat e kursit:

Ndër objektivat e këtij kursi është arritja e një kompetencë të lartë të gjuhës angleze me drejtim fushën e turizmit; familjarizimin me termat dhe nocionet kryesore të gjuhës së turizmit- Një objektiv tjetër është dhe ofrimi dhe përvetësimi nga studentët i njohurive sa më të mira të tematikave kulturore, historike, ekonomike dhe shoqërore të zonave të ndryshme gjeografike në gjuhën angleze dhe në kontekstin e turizmit dhe gjuhës së përdorur për zhvillimin e promovimin e tij, veçanërisht në Shqipëri; një pjesë të rëndësishme të ciklit të leksioneve zënë temat e gjuhës së turizmit të lidhura specifikisht me Shqipërinë, por më tepër me qytetet shqiptare nga vijnë studentët, duke trajtuar problematikat e turizmit shqiptar dhe gjuhën që përdoret apo që nuk përdoret e duhet të përdoret në promovimin e turizmit në vendin tonë.

#### Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do të kenë një kompetencë gjuhësore më të lartë, në gjuhën angleze, në të cilën zhvillohet dhe kursi. Një rezultat i pritshëm është një gjuhë e fjalor i pasuruar me shprehje e nocione të reja të fushave si semantika, komunikimi, gjuhësia, turizmi e sociolinguistika.

Një rezultat tjetër i pritshëm është ngritja në një nivel më të lartë e të menduarit vlerësues e kritik për turizmin dhe gjuhën që e përfaqëson atë, veçanërisht në kontekstin ku jetojmë. Studentët pritet të zhvillojnë kompetencat e tyre në lidhje me veçoritë e gjuhës së turizmit, teknikat e gjuhës së turizmit, regjistrat e gjuhës së turizmit etj.

#### Metoda didaktike

Për realizimin e kësaj lënde vihen në zbatim një sërë metodash didaktike, si ajo analitike e krahasuese. Ka përparësi metoda interaktive, ku studenti është në qendër të orës mësimore, dhe

çështje të ndryshme shqyrtohen nëpërmjet punës në grup. Përveç librave, shfrytëzohen gjithashtu artikuj shkencorë, apo materiale audio-vizive.

## VLERËSIMI

- Testi 1 15%
- Testi 2 15%
- Detyra e kursit 20 %
- Pjesmarrja dhe aktivizimi 10%
- Provimi Final 40%
- Total: 100%

## BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

The language of tourism, A sociolinguistic perspective, Graham M.S.Dann, CAB International, UK, 2001

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

Tourism Discourse, Language and global Mobility, Crispin Thurlow and Adam Jaworski, Palgrave Macmillan, 2010

### Gjuhe C (Nivel i avancuar)

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	<b>Gjuhe C (Nivel i avancuar)</b>
<b>Cikli:</b>	II
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhë angleze
<b>Kursi kurrikular</b>	Master i Shkencave, “Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor e turistik”
<b>Kursi:</b>	Viti I
<b>Viti/Semestri:</b>	I/I
<b>ETCS:</b>	6 ECTS
<b>Nr. Leksioneve:</b>	15 orë në auditor
<b>Nr. Seminareve:</b>	45 orë në auditor
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	

## PËRSHKRIMI I MODULIT

Kjo lënde synon t’u ofrojë studentëve njohuri të nivelit të avancuar në gjuhën angleze për ta përdorur atë si mjet komunikimi në jetën e përditshme dhe në ambiente të ndryshme ku mund të paraqitet nevoja e komunikimit me këtë gjuhë.

### Objektivat e kursit:

Në fund të kursit studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të pyesin dhe të përgjigjen në gjuhën angleze për tema të ndryshme të jetës së përditshme.
- Të komunikojnë me folës të tjerë të gjuhës angleze pa pasur probleme të të kuptuarit.
- Të diskutojnë për tema të ndryshme që ofrohen në libër por edhe nga vetë studentët.
- Të përdorin konceptet mbi mesatare të gjuhës angleze në dokumente zyrtare, në letra jozyrtare, në mesazhe elektronike dhe në histori të ndryshme.
- Të krijojnë dhe të shkruajnë histori duke përdorur fjalorin përkatës dhe të mëparshëm të marrë gjatë këtyre javëve mësimore.
- Të lexojnë dhe të kuptojnë një tekst te regjistrave te ndryshme dhe më pas të jenë të aftë ta përpunojnë atë.

### **Rezultatet e pritshme:**

- Të bëjë të mundur komunikim sa më të lirshëm.
- Studentët të pajisen me njohuri mbi mesatare gramatikore.
- Të mundësojë pjesëmarrje të studentëve në diskutime të plota dhe gjithëpërfshirëse.
- Të ndihmojë studentët të shkruajnë dhe të lexojnë rrjedhshëm në gjuhën angleze.

### **Metoda didaktike**

Per realizim e kesaj lende do te perdoret libri i studentit dhe libri i ushtrimeve, detyra te ndryshme, prezantime dhe pune ne grupe.

### **VLERËSIMI**

- Test i ndërmjetëm 1 = 20%
- Test i ndërmjetëm 2 = 20%
- Pjesëmarrja (përfshin përgjigjet në klasë dhe detyrat me shkrim të kërkuara gjatë semestrit) = 30%
- Provimi përfundimtar = 30%

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

- Harris M, Mower D, Sikorzysnka A. *New Opportunities, Upper-Intermediate, Student's book*, Longman
- Harris M, Mower D, Sikorzysnka A , *New Opportunities, Upper-Intermediate Language Powerbook*, Longman
- Jan Bell, Amanda Thomas, *Gold first certificate. New edition. Coursebook*, 2015
- Sally Burgess, Jacky Newbrook, *Gold First, Exam Maximiser*, 2015
- Clementine Annabell, Rawdon Wyatt, *Gold First, Teacher's Book*, 2015

### **BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR**

- Thomas, B J, *Advanced Vocabulary and Idiom*, Nelson, 1991
- Lynn Lundquist, *Spoken English Learned Quickly*, 2008
- <http://iteslj.org/questions/>

- [www.newsdirectory.com](http://www.newsdirectory.com)
- [www.theworldpress.com](http://www.theworldpress.com)
- [www.FreeEnglishNow.com](http://www.FreeEnglishNow.com)
- <http://www.flo-joe.com/fce/students/tests/tsindex.htm>
- [http://www.examenglish.com/FCE/Use\\_of\\_English.htm](http://www.examenglish.com/FCE/Use_of_English.htm)

### **Përkthim dhe Interpretim B në A**

<b>Programi i lëndës</b>	
<b>Moduli:</b>	Përkthim dhe Interpretim B në A
<b>Cikli:</b>	Master Shkencor
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhë, komunikim ndërkulturor dhe turistik
<b>Kursi kurrikular</b>	Viti I anglisht
<b>Kursi:</b>	I anglisht
<b>Viti/Semestri:</b>	I/II (i dytë)
<b>ETCS:</b>	8 Kredite - (= 80 orë);
<b>Nr. Leksioneve:</b>	(= 15 orë);
<b>Nr. Seminareve:</b>	(= 65 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Iris Kokoli (Klosi) (lektore)

#### **PËRSHKRIMI I MODULIT**

Lënda Përkthim dhe Interpretim B në A zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të parë të Masterit Shkencor në Gjuhë, Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik. Lënda përmban gjithsej 80 orë nga të cilat 15 janë leksione dhe 65 seminare.

Kjo lëndë synon të pajisë studentët me njohuri të mëtjeshme mbi teorinë dhe praktikën e përkthimit dhe interpretimit. Temat janë konceptuar të jenë të kuptueshme dhe në funksion të profilit të studimeve master. Niveli i temave të zgjedhura përputhet me nivelin e studentëve të cilët pritet të kenë aftësi analitike dhe interpretative dhe të përmirësojnë më shumë aftësitë e tyre gjuhësore dhe mënyrën e të menduarit nëpërmjet diskutimeve të shumta gjatë seminareve. Metodologjia e përdorur do të jetë nëpërmjet ciklit të leksioneve të siguruara nga pedagogu i lëndës, libri bazë si dhe materiale shtesë në formë artikujsh.

#### **Objektivat e kursit:**

Ky kurs synon:

- të pajisë studentët me njohuri shtesë mbi teorinë dhe praktikën e përkthimit dhe interpretimit, ku një pjesë njohurish të përgjithshme pritet t'i kenë përvetësuar në ciklin Bachelor.
- T'u japë njohuritë e mjaftueshme në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të kuptojnë dhe perceptojnë mirë temat e caktuara nga pedagogu i lëndës.
- të zhvillojë më tej aftësitë e studentëve në lidhje me shprehjen e mendimeve kritike, komenteve, parashtrimin të një çështjeje për diskutim.

#### **Rezultatet e pritshme:**

Në këtë kurs studentët pritet:

- të përvetësojnë njohuritë mbi teorinë dhe praktikën e përkthimit dhe interpretimit.
- Të shtrojnë probleme dhe të nxjerrin përfundime
- Të përgatisin detyrat me një kompetencë gjuhësore dhe kulturore të nivelit master
- Të kenë zhvilluar aftësitë e tyre analitike, gjuhësore dhe kritike në lidhje me çështjet.

### **Metoda didaktike**

Metoda didaktike e përdorur janë leksionet e përgatitura nga pedagogu i lëndës, literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar, diskutime, ushtrime dhe pyetje gjatë ciklit të seminareve, provim mes-semesteral, projekt përfundimtar dhe provim përfundimtar.

### **VLERËSIMI**

- Studentët duhet të ndjekin të paktën deri 80% të totalit të orëve (64 orë).
- Të gjitha detyrat e përcaktuara nga pedagogu duhet të dorëzohen në afatin e duhur.
- Projektet vlerësohen me 20%
- pjesëmarrja aktive dhe diskutimet vlerësohen me 20 %,
- provimi mes-semesteral vlerësohet me 20 %.

Provimi përfundimtar me 40 %.

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

- Hatim, B. and Munday, J. Translation An advanced resource book, Routledge, 2004.
- Ristani, V., Kontribut në Studimet Përkthimore gjatë viteve '90" (Monografi), Seria e Studimeve Përkthimore, GEER, Tiranë, 2010.
- Kopje elektronike e leksioneve të titullarit të lëndës.

### **BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR**

- Baker, M., *"In other Words", - A Coursebook on Translation*, Routledge, London and New York, 1992.
- Bassnett-McGuire, S. *"Translation Studies"* Routledge, London & New York, 1992.
- Bell R.T. *"Translation and Translating" - Theory and Practice*, Longman, London and new York, 1998
- Kokona, V., *Mbi përkthimin, me perkthyesin*, Botimet Kokona, Tirane 2003, 133 faqe
- Newmark, P. *"A Textbook of Translation"*, Prentice Hall, London, 1988.
- Qatipi, Sh. *Disa probleme të proverbeve në gjuhën angleze vështruar në përqsje me gjuhën shqipe*, ISBN: 978-9928-07-045-6, 2012
- Robinson, D., *Becoming a Translator – An Accelerated Course*, Routledge, London and New York, 1997.
- Seleskovitch, D., Lederer, M., *Interpreter pour traduire*, Didier Erudition, Paris 1984.
- Snell-Hornby, M. *Translation Studies - An Integrated Approach*, John Benjamin B., Amsterdam, Philadelphia 1988.
- Steiner, G. *"After Babel. Aspects of Language and Translation"*, London: Oxford University Press, 1977.

## Letërsi dhe kulturë C

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Letërsi dhe kulturë C
<b>Cikli:</b>	Master
<b>Fusha e formimit</b>	Letërsi
<b>Kursi kurrikular</b>	Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Komunikim Ndërkulturor e Turistik”
<b>Kursi:</b>	I
<b>Viti/Semestri:</b>	I/Semestri II
<b>ETCS:</b>	8 Kredite - (= 80 orë);
<b>Nr. Leksioneve:</b>	6 Kredite - (= 60 orë);
<b>Nr. Seminareve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Albert Sheqi, Dr. Esmeralda Subashi, Dr. Loran Gami, Dr. Manjola Nasi

### PËRSHKRIMI I MODULIT

Ky modul zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të parë në studimet master të degës Gjuhës dhe Komunikimit Ndërkulturor dhe Turistik. Kursi synon t’u ofrojë studentëve një bazë njohurish për kulturën dhe letërsinë e vendeve anglishtfolëse, duke u përqendruar tek arti, letërsia, organizimi institucional dhe aspekte të ndryshme të qytetërimit britanik dhe amerikan.

### Objektivat e kursit:

Ky kurs synon:

- T’u japë studentëve njohuri mbi letërsinë dhe qytetërimin anglez e amerikan.
- Të ofrojë një panoramë të përgjithshme të zhvillimit shoqëror e institucional në vendet kryesore anglishtfolëse.
- T’i nxisë studentët, veçanërisht gjatë seminareve, që t’i mprehin aftësitë e të menduarit kritik.
- Të përmirësojë aftësitë e studentëve në gjuhën angleze.

### Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët:

- do të kenë njohuri të mira për zhvillimet kryesore në fushën e artit dhe letërsisë në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- do të kenë njohuri më të mira për aspektet e ndryshme të historisë dhe të qytetërimit në Mbretërinë e Bashkuar dhe në ShBA.
- do të njohin disa nga autorët kryesorë dhe veprat më të rëndësishme të letërsisë britanike dhe asaj amerikane.
- do të përmirësojnë mendimin e tyre kritik.
- do të përmirësojnë nivelin e tyre të përvetësimit të gjuhës.

### Metoda didaktike



Leksione dhe seminare.

## VLERËSIMI

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

## BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

- *The Norton Anthology of English Literature*, M.H.Abrams, General Editor, New York: W.W.Norton & Company: 1996. (5-10, 65-70; 253-270, 1261-1273; 1833-1851; 2135-2143)
- John Oakland, *British Civilization: An Introduction*, London, New York: Routledge: 1992 ose Botimin e gjashtë të këtij libri, 2006. (8-18; 23-31; 32-47; 48-80; 94-108; 109-134; 135-156; 172-191; 192-210)
- *Oxford Anthology of English Literature: Romantic Poetry and Prose*, Harold Bloom, Lionel Trilling, New York: Oxford University Press: 1973. (592-611)
- Kennedy, X.J., *Literature: an Introduction to Fiction, Poetry, and Drama*. Fourth Edition; Little, Brown and Company, 1987.
- *An Outline of American Government* - (Vështrim mbi sistemin amerikan të qeverisjes) Botim i Zyrës së Programeve Ndërkombëtare të Informacionit të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara.
- Leksione të përgatitura nga lektorët.

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- Andrew Sanders, *The Short Oxford History of English Literature*, Oxford: Clarendon Press, 1994.
- Bain, E. Carl, *The Norton Introduction to Literature*, W.W. Norton & Company, Sixth Edition, 1995.
- Cassill, R.V. *The Norton Anthology of Short Fiction*, W.W. Norton & Company, 1978.
- Allen, Derek R et al. *Words, Words, Words 2 - A History and Anthology of Literatures in English with Audio CD*. La Spiga Languages, 2003.

### Gjuhe C (Nivel i avancuar)

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	<b>Gjuhe C (Nivel i avancuar)</b>
<b>Cikli:</b>	II
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhë angleze
<b>Kursi kurrikular</b>	Master i Shkencave, “Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor e turistik”
<b>Kursi:</b>	Viti I
<b>Viti/Semestri:</b>	I/I
<b>ETCS:</b>	6 ECTS
<b>Nr. Leksioneve:</b>	15 orë në auditor

<b>Nr. Seminareve:</b>	45 orë në auditor
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	

## **PËRSHKRIMI I MODULIT**

Kjo lënde synon t'u ofrojë studentëve njohuri të nivelit të avancuar në gjuhën angleze për ta përdorur atë si mjet komunikimi në jetën e përditshme dhe në ambiente të ndryshme ku mund të paraqitet nevoja e komunikimit me këtë gjuhë.

### **Objektivat e kursit:**

Në fund të kursit studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të pyesin dhe të përgjigjen në gjuhën angleze për tema të ndryshme të jetës së përditshme.
- Të komunikojnë me folës të tjerë të gjuhës angleze pa pasur probleme të të kuptuarit.
- Të diskutojnë për tema të ndryshme që ofrohen në libër por edhe nga vetë studentët.
- Të përdorin konceptet mbi mesatare të gjuhës angleze në dokumente zyrtare, në letra jozyrtare, në mesazhe elektronike dhe në histori të ndryshme.
- Të krijojnë dhe të shkruajnë histori duke përdorur fjalorin përkatës dhe të mëparshëm të marrë gjatë këtyre javëve mësimore.
- Të lexojnë dhe të kuptojnë një tekst te regjistrave te ndryshme dhe më pas të jenë të aftë ta përpunojnë atë.

### **Rezultatet e pritshme:**

- Të bëjë të mundur komunikim sa më të lirshëm.
- Studentët të pajisen me njohuri mbi mesatare gramatikore.
- Të mundësojë pjesëmarrje të studentëve në diskutime të plota dhe gjithëpërfshirëse.
- Të ndihmojë studentët të shkruajnë dhe të lexojnë rrjedhshëm në gjuhën angleze.

### **Metoda didaktike**

Per realizim e kesaj lende do te perdoret libri i studentit dhe libri i ushtrimeve, detyra te ndryshme, prezantime dhe pune ne grupe.

### **VLERËSIMI**

- Test i ndërmjetëm 1 = 20%
- Test i ndërmjetëm 2 = 20%
- Pjesëmarrja (përfshin përgjigjet në klasë dhe detyrat me shkrim të kërkuara gjatë semestrit) = 30%
- Provimi përfundimtar = 30%

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

- Harris M, Mower D, Sikorzysnka A. *New Opportunities, Upper-Intermediate, Student's book*, Longman
- Harris M, Mower D, Sikorzysnka A , *New Opportunities, Upper-Intermediate Language Powerbook*, Longman
- Jan Bell, Amanda Thomas, *Gold first certificate. New edition. Coursebook*, 2015
- Sally Burgess, Jacky Newbrook, *Gold First, Exam Maximiser*, 2015
- Clementine Annabell, Rawdon Wyatt, *Gold First, Teacher's Book*, 2015

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- Thomas, B J, *Advanced Vocabulary and Idiom*, Nelson, 1991
- Lynn Lundquist, *Spoken English Learned Quickly*, 2008
- <http://iteslj.org/questions/>
- [www.newsdirectory.com](http://www.newsdirectory.com)
- [www.theworldpress.com](http://www.theworldpress.com)
- [www.FreeEnglishNow.com](http://www.FreeEnglishNow.com)
- <http://ww.flo-joe.com/fce/students/tests/tsindex.htm>
- [http://www.examenglish.com/FCE/Use\\_of\\_English.htm](http://www.examenglish.com/FCE/Use_of_English.htm)

### Përkthim dhe Interpretim C në A

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	<b>Përkthim/Interpretim C në A</b>
<b>Cikli:</b>	Master
<b>Fusha e formimit</b>	Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik
<b>Kursi kurrikular</b>	Master shkencor
<b>Kursi:</b>	II (gjuhët frënge, italiane, turke, spanjolle, greke)
<b>Viti/Semestri:</b>	II/1
<b>ETCS:</b>	6 Kredite - (= 60 orë);
<b>Nr. Leksioneve:</b>	
<b>Nr. Seminareve:</b>	6 Kredite - (= 60 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof.dr. Daniela Tamo, Dr. Jonida Petro

## PËRSHKRIMI I MODULIT

Lënda Përkthim/Interpretim C në A zhvillohet në semestrin e parë të vitit të dytë të Masterit Shkencor në Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik. Lënda përmban gjithsej 60 orë, tërësisht të realizuara në formën e seminareve.

Nëpërmjet kësaj lënde synohet që studentët të njihen më tej me koncepte teorike dhe praktike të përkthimit dhe interpretimit në kuadrin tanimë të studimeve të Komunikimit Ndërkulturor dhe Turistik. Temat janë konceptuar të jenë në vazhdimësi të njohurive të përvetësuara në ciklin 'Bachelor' dhe në përputhje me aftësitë e nivelin gjuhësor të studentëve në gjuhën 'C', aftësi të cilat do të shfrytëzohen dhe në funksion të profilit të studimeve master. Seminaret do të përfshijnë diskutime e detyra që studentët të kenë mundësi të vënë në jetë çështje teorike e praktike me ndihmesën e pedagogeve së lëndës në drejtim të aftësive përkthuese/interpretative. Kështu ata do të zhvillojnë aftësi të reja komunikuese, shkruese e trajtuese. Pedagogët do të

krijonjë mjedis të përshtatshëm për të punuar në grupe ose edhe individualisht sipas rastit dhe temës.

### **Objektivat e kursit:**

Ky kurs synon:

- të pajisë studentët me njohuri të mëtejshme kyçe për teorinë dhe praktikën e përkthimit/interpretimit në kuadrin e studimeve të komunikimit ndërkulturor, ku një pjesë njohurish të përgjithshme studentët përkatës pritet t'i kenë përvetësuar në ciklin 'Bachelor';
- t'u japë njohuritë e mjaftueshme në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të kuptojnë dhe perceptojnë mirë nga kulturat dhe gjuhët C - A temat e caktuara nga pedagogu i lëndës;
- të zhvillojë më tej aftësitë e studentëve në lidhje me shprehjen e mendimeve kritike, komenteve, parashtrimit të një çështjeje për diskutim në fushën e përkthimit;
- të zhvillojë më tej aftësitë e studentëve për të interpretuar nga gjuha C në gjuhën A.

### **Rezultatet e pritshme:**

Studentët duhet të jenë të aftë:

- të përkthejnë me shkrim dhe gojë materiale dhe ligjërime;
- të hartojnë ligjërime sipas fushave të caktuara;
- të përmirësojnë aftësitë e të folurit publik dhe të menaxhimit të stresit;
- të arrijnë të analizojnë në mënyrë të pavarur tekste nga 2-3 zhanre që lidhen me fushën e tyre të studimit si psh. tekste me terma nga fusha e turizmit, reklamave, shkencore, ekonomike;
- të arsyetojnë mbi strategjitë përkthimore bazë që ata vetë dhe kolegët e tyre, shfrytëzojnë gjatë procesit të përkthimit dhe interpretimit, që në të ardhmen t'i përdorin si instrumenta të gatshëm;
- të përgatisin detyrat me një kompetencë gjuhësore dhe kulturore të nivelit master.

### **Metoda didaktike**

Programi realizohet përmes seminareve, ushtrimeve, prezantimeve, punës në grup dhe detyrave dhe provimit përfundimtar.

### **VLERËSIMI**

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

- Andrew, G., (2013): *Conference Interpreting, A Student's Practice Book*, Routledge

- Andrew, G., (2005): *Note-Taking for Consecutive Interpreting - A Short Course*, Manchester, St. Jerome Publishing
- Baker, M., (1992): *In other words a course book on translation*, London and New York: Routledge
- Basil, H. and Jeremy, M., (2004): *Translation. An advanced resource book*. Routledge. London and New York. 2004
- Duff, A., (1989): *Translation*, Oxford University Press
- Gile, D., (1995): *Basic Concepts and Models For \Interpreter and Translator Training*, Benjamins Translation Library
- James, N., (2005): *Interpretation: Techniques and Exercises* (Professional Interpreting in the Real World, Multilingual Matter
- James, K., Jordan, R., Matthews, A., O'Brien, J., (1991): *Listening Comprehension and Note-Taking Courses*, Collins Study Skills in English
- Newmark, P., (1988): *A textbook of Translation*, Prentice Hall International

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

Preferohet që studentët e kësaj lënde të shfrytëzojnë jo vetëm artikuj, enciklopedi e botime të ndryshme nga fusha e studimeve përkthimore, por edhe website të shumta që ofrojnë informacion të përditësuar për risitë në këtë fushë. Kryesisht do të udhëzohen nga pedagogët në drejtim të gjetjes së fjalorëve të përshtatshëm dhe corpusit të nevojshëm që lënda të jetë njëkohësisht sa më e përfutueshme dhe e pëlqyeshme.

### Strategji Komunikimi

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	<b>Strategji Komunikimi</b>
<b>Cikli:</b>	<b>II</b>
<b>Fusha e formimit</b>	<b>Komunikim</b>
<b>Kursi kurrikular</b>	<b>Master i Shkencave</b>
<b>Kursi:</b>	<b>II</b>
<b>Viti/Semestri:</b>	<b>II/I</b>
<b>ETCS:</b>	<b>6 ects</b>
<b>Nr. Leksioneve:</b>	<b>30 leksione</b>
<b>Nr. Seminareve:</b>	<b>30 seminare</b>
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	<b>Dr. Rudina Vriani Dr. Albana Çoni</b>

## PËRSHKRIMI I MODULIT

### Objektivat e kursit:

Kursi Strategji Komunikimi është ndërtuar duke patur në vëmendje aftësitë komunikuese që kërkon sot shoqëria. Studentët do të sintetizojnë dhe aplikojnë njohuri dhe aftësi të fituara më parë gjatë studimeve për të dëshmuar kompetencë në fusha të specializuara të komunikimit strategjik. Kursi ofron njohuri dhe ekspertizë në organizimin dhe përshtatjen e mesazheve në varësi të konteksteve të ndryshme, të krijojnë dhe prezantojnë prezantime të nivelit profesional, të përmirësojnë aftësitë komunikuese në grup dhe skuadër, të formatojnë raporte biznesi,

propozime, letra dhe të ngjashme në kontekst organizate, institucioni dhe biznesi, e të tjerë. Kursi ofron njohuri të thelluara të praktikave komunikative si menaxhimin e krizave, komunikimin në institucion dhe etikën e komunikimit.

### **Rezultatet e pritshme:**

- Studentët do të zhvillojnë strategji të komunikimit, do të jenë të aftë të sintetizojnë literaturën dhe analizojnë proceset e strategjive të komunikimit.
- Studentët do të përmirësojnë aftësitë e të shkruarit duke thelluar njohuritë e fituara më parë mbi parimet e sukseshme të të shkruarit dhe do t'i praktikojnë këto aftësi në detyrat më shkrim gjatë kursit.
- Studentët do të përmirësojnë aftësitë e të prezantuarit duke thelluar njohuritë mbi teknikat e prezantimit, përmirësuar aftësitë bindëse dhe përdorimin e mjeteve vizuale.
- Studentët do të përmirësojnë aftësitë për të punuar në grup dhe skuadër duke kuptuar qartë rëndësinë e menaxhimit të skuadrës, dinamikën e saj dhe stilin e komunikimit në këto kontekste. Ata do t'i praktikojnë këto aftësi në punë të ndryshme në skuadër.
- Studentët do të nxënë mbi komunikimin në biznese dhe organizata, do të zgjerojnë njohuritë mbi teknologjinë në vendin e punës si dhe kanalet e ndryshme të komunikimit dhe multimedia.

### **Metoda didaktike**

- Metoda të ndryshme didaktike, me ndërthurje të gjerë të stileve të ndryshme në mësimdhënie, kanë provuar se lektori ka më shumë fleksibilitet në përshtatjen e kursit me pritshmëritë e studentëve. Duke patur në vëmendje larminë e klasave, ndërthuren leksionet, seminarët, puna në grup, prezantimet dhe detyrat e kursit.

### **VLERËSIMI**

- Vlerësimi i vazhdueshëm 20%
- Pjesëmarrja 10 %
- Prezantimet me gojë/estetë 10 %
- Provimi 'mid term' 20%
- Provimi përfundimtar 40 %

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

- Introduction to communication studies, John Fiske, second edition, by Routledge
- Communication Mosaics: A new introduction to the field of communication, Julia T. Wood, Wadsworth Publishing Company
- The Art of Public Speaking, 6-th edition, Stephen E Lucas, McGraw Hill

### **BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR**

- Pearson J., Nelson P., An introduction to human communication, understanding and sharing.
- Mc Nair, B., Hyrje në komunikimin politik UET Press,.

- McQuail, D., Mass Communication Theory, London Sage,
- Munslow, A. Discourse and Culture, London: Routledge.

### Metodologji e kërkimit shkencor

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Metodologji e kërkimit shkencor
<b>Cikli:</b>	I dyte
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhe dhe komunikim nderkulturor dhe turistik
<b>Kursi kurrikular</b>	Master
<b>Kursi:</b>	II
<b>Viti/Semestri:</b>	Viti II (Komunikim)/ i pare
<b>ETCS:</b>	Kredite - (= 100 orë); 6 kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b>	Kredite - (= 40 orë); 4 kredite
<b>Nr. Seminareve:</b>	Kredite - (= 20 orë). 2 kredite
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Elvana Shtëpani Dr. Miranda Veliaj

### PËRSHKRIMI I LËNDËS

Lënda e Metodologjisë së kërkimit shkencor parashtrohet një sërë konceptesh, metodash dhe mjeteve me anë të të cilave ndërtohet kërkimi shkencor në fushën e komunikimit dhe se si interpretohet apo vlerësohet ai. Informacioni që prezantohet tek studentët nëpërmjet kësaj lënde i ndihmon ata të përftojnë aftësitë e nevojshme për të grumbulluar, organizuar, interpretuar dhe parashtruar informacionin e marrë duke përdorur metodat e duhura të kërkimit shkencor. Lënda i njeh studentët me ndryshimet midis kërkimit sasior dhe cilësor, në lidhje me rolin e kërkuesit, me supozimet e tij për realitetin dhe duke vënë theksin në kërkimet në vendin e punës, në përdorimin e metodave të ndryshme, metodat statistikore të zakonshme si dhe në procesin e shkruarjes së punimit dhe përgatitjes së tij për botim.

### Objektivat e kursit:

Ky kurs synon të ndihmojë studentët të përvetësojnë konceptet dhe fjalorin e nevojshëm të metodologjisë së kërkimit shkencor, të kuptojnë marrëdhënien mes teorisë dhe metodave të kërkimit përgjatë studimit të komunikimit si një shkencë shoqërore si dhe të vlerësojë përzgjedhjet etike të kërkuesve gjatë drejtimit dhe prezantimit të punës kërkimore. Objektiva të tjera në shërbim të studentëve lidhen me krahasimin e metodave kryesore kërkimore si dhe me zhvillimin e aftësive të nevojshme për të realizuar punën kërkimore në fushën e komunikimit si dhe të aftëshet për të shprehur qartë rezultatet e punës kërkimore.

### Rezultatet e pritshme:

Pas përfundimit të kursit pritet që studentët të kenë përftuar njohuritë e nevojshme lidhur me metodat e ndryshme të kërkimit shkencor në fushën e komunikimit si dhe të jenë aftësuar për të realizuar me sukses procesin e plotë të punës kërkimore që me grumbullimin e të dhënave deri në arritjen e përfundimeve të nevojshme.

### Metoda didaktike

Metodat didaktike që do të përdoren janë leksionet, seminaret, prezantimet, diskutimet në grup si dhe ushtrimet e ndryshme që do të realizohen për të qartësuar problematikat.

## **VLERËSIMI**

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

## **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

- Frey, L. R., Botan, C. H., & Kreps, G. L. Investigating communication: An introduction to research methods (2nd ed.). Needham Heights, MA: Allyn & Bacon. (2000).
- Dawson, C. A practical guide to research methods, Spring Hill House, Spring Hill Road, Begbroke, Oxford OX5 1RX. United Kingdom, 2007

## **BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR**

- Keyton , J. Communication Research: Asking Questions, Finding Answers McGraw-Hill Humanities/Social Sciences/Languages; 3 edition,2010
- Reinard, J. Introduction to Communication Research, 4th Edition McGraw-Hill; 2007
- Rubin, R. B., Palmgreen, P., & Sypher, H. E. Communication research measures: A sourcebook. New York: Guilford Press 1994
- Johnson , B. & Christensen, L. Educational Research. Quantitative, Qualitative and mixed approaches. Allyn & Bacon, 2004

**MIRATOI**

**PERGJEGJESI I DEPARTAMENTIT**  
**Prof. Dr. Viktor RISTANI**

**DEKANI**  
**Prof. Dr. Artur SULA**